

With funding from

 Austrian
Development
Cooperation



Vlerësimi i Nexus për Shqipërinë

Përmbledhje e gjetjeve kryesore

© Thomais Vlachogianni/MIO-ECSD





Qasja e Nexus është veçanërisht e rëndësishme për Shqipërinë, duke patur parasysh burimet e pasura ujore, shpërndarjen e konsiderueshme të hidrocentraleve në përzierjen energjetike, rolin kyç socio-ekonomik në bujqësi dhe zonat e mëdha natyrore me vlerë të lartë ekologjike.

Arritja e qëndrueshmërisë së klimës duke garantuar sigurinë e ujit – energjisë – dhe ushqimit janë parakushtet kryesore për rritjen ekonomike, mirëqënien njerezore dhe ekosisteme të shëndetshme në vend.

Arritje të rëndësishme, veçanërisht në lidhje me mjediset institucionale, kanë ndodhur gjatë viteve të fundit në drejtim të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Megjithatë, politikat dhe praktikave të pa integruara dhe të pa koordinuara mbeten një sfidë thelbësore. Një qasje e integruar dhe e kuptueshme në hartimin dhe vendosjen e prioritetit për opsionet e politikave, praktikave të menaxhimit dhe planifikimit të infrastrukturës, do të siguronte maksimizimin e përfitimeve të përgjithshme në të gjithë sektorët.

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit të Nexus është të lehtësojë kuptimin e gjerë të marrëdhënieve komplekse dhe dinamike midis ujit, energjisë, bujqësisë/përdorimit të tokës dhe ekosistemeve, dhe përmirësimin e koordinimit mbi aspektet e politikave dhe menaxhimit, duke identifikuar kompromiset dhe sinergjitë në të gjithë sektorët e lidhur me Nexus



KARAKTERISTIKAT
KRYESORE TË SEKTORËVE
TË NEXUS NË SHQIPËRI



NDËRLIDHJET KRYESORE
(SINERGJITË DHE
KOMPROMISET) NË TË
GJITHË SEKTORËT E
NEXUS





NDËRLIDHJET KRYESORE
TË ZBULUARA






KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË SEKTORËVE TË NEXUS NË SHQIPËRI





Menaxhim i Burimeve Ujore

Shqipëria po përparon në menaxhimin e integruar të burimeve të saj ujore, në përputhje me legjislacionin e posaçëm të BE. Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore janë përgatitur për dy prej baseneve kryesore të tij, ndërsa tre të tjerë janë në proces e sipër. Me reshje mesatare vjetore të bollshme, Shqipëria ndeshet shpesh me problemin e përmbajtjeve – që zakonisht ndodhin në periudhën Nëntor – Mars.



Furnizimi me ujë dhe Kanalizimet

Mbulimi i shërbimeve për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në Shqipëri është afërsisht 77% dhe 53%, ku mbulimi është dukshëm më i ulët në zonat rurale. Pjesa e ujit pa përfitim mbetet shumë e lartë – rreth 63%. Ndërmarrjet e ujësjellësit po përballen me sfida të mëdha për qëndrueshmërinë e tyre financiare.



Ushqimi / Bujqësia

Në Shqipëri, bujqësia ofron rreth 40% të punësimit dhe 19% të GDP. Vendi është importues neto i produkteve bujqësore dhe ushqimore. Madhësia mesatare e fermës familjare në vend është relativisht e vogël. 626 rezervuaret janë shtylla kryesore e infrastrukturës së vaditjes, por kapaciteti i tyre aktual ujqor është pak më i lartë se gjysma e atij nominal, për shkak të erozionit dhe mirëmbajtjes së dobët. 360,000 ha janë të pajisura me infrastrukturë vaditëse, por është funksionale vetëm në gjysmën e asaj zone.



Energjia

Sfida kryesore për Shqipërinë është si të rritim konsumin e ulët të energjisë për frymë në kuadër të objektivave të zhvillimit, ndërkohë që zvogëlohet niveli i lartë i intensitetit të energjisë dhe përmbushja e angazhimeve që kanë lidhje me klimën. Shqipëria mbetet një importuese neto e energjisë në përgjithësi dhe e energjise elektrike – në disa vite. Prodhimi i energjisë elektrike në Shqipëri ka qënë pothuajse i dominuar nga prodhimi i hidroçentraleve, por energjia e erës dhe e diellit pritet të luajnë një rol të dukshëm në rritje.



Mjedisi

Zonat e mbrojtura në Shqipëri zënë 18% të territorit, me synimin e qeverisë për ta rritur këtë. Pyjet zënë rreth 36% të sipërfaqes së vendit. Druri ka qënë burimi tradicional i lëndës djegëse në familje. Megjithatë prerjet e paligjshme kanë ndikuar negativisht tek pyjet, gjë që bëri që Qeveria të vendosë një moratorium 10-vjeçar për prerjet në vitin 2016.

NDËRLIDHJET KRYESORE (SINERGJITË DHE KOMPROMISET) NË TË GJITHË SEKTORËT E NEXUS

Raporti po ashtu ofron një pasqyrë të shkurtër të strukturave strategjike dhe vendim-marrëse për çdo sektor të Nexus, dhe një vlerësim të shpejtë se si ato trajtojnë konsideratat ndër-sektoriale. Bazuar tek të gjitha gjetjet e mësipërme, raporti identifikon ndërlidhjet kryesore – si marrëdhëniet negative (kompromiset) dhe mundësitë për sinenergjitë – në të gjithë sektorët e Nexus në fushat prioritare të politikave. Një hartë e detajuar e ndërlidhjeve është në dispozicion në Raport dhe paraqitet në Fletën e të Dhënave shoqëruese.



Tabela me poshtë paraqet një pamje të ndërlidhjeve kryesore, të strukturuar sipas objektivave kryesore të politikës të secilit sektor.



Furnizimi me ujë dhe Kanalizimet

Objektivat e Politikave	Sinergjitë	Kompromiset
Expanding and improving access to water & sanitation services / Construction of wastewater Treatment Plants.	<p>Bujqësia: Mundësia për më shumë ujë (të përpunuar) për vaditje, dhe përdorim i trajtimit të papastërtive.</p> <p>Energjia: Mundësia për rikuperimin e energjisë (biogaz) dhe/ose instalimet në terren të energjisë së rinovueshme.</p> <p>Mjedisi: Reduktim i ndotjes – përmirësim i cilësisë së ujit.</p>	<p>Energjia: Kërkesa e shtuar e energjisë për rrjedhën dhe trajtimin e ujit.</p>
Rikuperim i plotë i kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes / Përmirësim i Qeverisjes së Korperatës dhe kapaciteteve	<p>Burimet ujore: Performanca e përmirësuar dhe operimet e përgjithshme do të rezultojnë në rritje të efikasitetit dhe reduktim të humbjeve të ujit.</p> <p>Energjia: Përmirësim i efijencës së energjisë është parakusht për qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjeve.</p>	



Ushqimi / Bujqësia / Përdorim i tokës

Objektivat e Politikave

Përmirësim i shërbimeve të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, duke reduktuar pasojat e përmbytjeve dhe thatësirave.

Pyllëzim dhe parandalim i erozionit të tokës.

Sinergjitë

Menaxhim i burimeve ujore: Lehtësohet ndikim i përmbytjeve / thatësirës.

Energjia: Mundësi për rritje të eficiencës së energjisë dhe /ose

Instalime në terren të energjisë së rinovueshme (p.sh. agro -fotovoltaikeve).

Mjedisi: Mundësi për praktika të qëndrueshme që zvogëlojnë përdorimin e pesticideve, ruajtjen e cilësisë së ujit dhe biodiversitetit.

Energjia: Trajtim i erozionit të tokës redukton sedimentimin në rezervuar.

Mjedisi: Asistencë në përmbushjen e objektivave të restaurimit të tokës.

Furnizimi me ujë: Pyllëzimi mund të çojë në përmirësim të cilësisë së ujit.

Kompromiset

Energjia: Rritje e kërkesës për energji, për shërbime dhe pajisje shtesë për ujitje dhe kullim.



Energjia

Objektivat e Politikave

Zhvillim i qëndrueshëm i hidroçentraleve.

Rritja e sigurisë dhe përballimi i furnizimit me energji / Promovimi i burimeve të rinovueshme të energjisë dhe eficienta e energjisë.

Sinergjitë

Menaxhim i burimeve ujore:

Mundësi për përmirësimin e menaxhimit të përmbytjeve në rast të funksionimit të kordinuar të HEC-eve.

Mundësi për instalimin e impianteve lundruese diellore në rezervuar.

Bujqësia: Rritje e kapaciteteve të rruajtjes së ujit.

Menaxhim i burimeve ujore: Përmirësim i Burimeve të Rinovueshme jo hidro do të reduktojë nevojën për HEC-e shtesë dhe streseve të lidhura me ato.

Furnizimi me ujë dhe kanalizimi: Rritje e eficientës së energjisë përmirëson qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjeve.

Bujqësia: Instalimet në terren të energjisë së rinovueshme (p.sh agro-fotovoltaiket).

Rritje e eficientës së energjisë redukton kostot për fermerët.

Mjedisi: Ngrohja efiçente redukton nevojën për lëndën djegëse të drurit dhe prerjen e papërshtatshme.

Kompromiset

Mjedisi: Mundësi për ndikimet negative të larta në ekosistemet pa një vendndodhje të duhur dhe Vlerësim të plotë të Ndikimit në Mjedisi.

Zhvillim i Hidroçentraleve duhet të marrë në konsideratë ndikimet që priten nga ndryshimet klimaterike.

Bujqësia: Konfliktet e mundshme nga zënia e tokave në rezervuare dhe problemet për shpërndarjen e ujit.

Bujqësia: Instalimet diellore në tokat bujqësore dhe/ose kalimi në biokarburante do të reduktojë tokat bujqësore në dispozicion për prodhimin ushqimor.

Strese të mundshme shtesë për disponueshmërinë e ujit në rastin e kultivimit të biokarburanteve.

Mjedisi: Mundësi për ndikime të mëdha negative në ekosistemet nga vendndodhja e dëmshme e fermave të erës në zona natyrore dhe/ose përdorim i papërshtatshëm i biomasës.



Mjedisi dhe Biodiversiteti

Objektivat e Politikave	Sinergjitë	Kompromiset
<p>Uje i mjaftueshëm për shërbimet e ekosistemit</p>	<p>Menaxhim i burimeve ujore: Mund të kërkohen ndryshime për rregullat për shpërndarjen dhe lejimin e ujit.</p>	<p>Energjia: Nevoja për të siguruar rregulla të përshtatshme për flukset mjedisore të operimit të HEC-eve.</p> <p>Bujqësia: Mosmarrëveshje të mundshme në rastin e burimeve të pamjaftueshme.</p>
<p>Zgjerim i sistemeve të zonave të mbrojtura.</p>		<p>Bujqësia: Mosmarrëveshje të mundshme për përdorimin e tokës.</p> <p>Energjia: Ndikimet e mundshme për vendndodhjen e instalimeve të BRE.</p>
<p>Përmirësim i Proçesit SEA / EIA.</p>	<p>Furnizimi me ujë dhe kanalizimi: Zvogëlim i ndikimeve të mundshme nga instalimet për Sistemin e Furnizimit me Ujë (WSS).</p> <p>Bujqësia: Qëndrueshmëri e përmirësuar e prodhimit bujqësor.</p>	<p>Energjia: Ndikimet e mundshme mbi vendndodhjen e instalimeve të BRE.</p>

NDËRLIDHJET KRYESORE TË ZBULUARA


Raporti po ashtu zbulon me detaje të mëdha tre ndërlidhjet e mëposhtme, duke identifikuar pengesat kryesore dhe sugjeruar masat zbutëse me përfitime ndër-sektoriale:



NDËRLIDHJA E FUNKSIONIMIT TË HIDROÇENTRALEVE DHE MENAXHIMIT TË PËRMBYTJEVE

Në Shqipëri, zona të mëdha të rrjedhës së poshtme janë të prirura nga përmbytjet dhe mungesa e rregullimit të duhur dhe të fortë të Hidrocentraleve (HEC-eve) dhe rrjedhave ujore që lidhura me to, mund të përkeqësojë problemin e përmbytjeve.


Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) është i ngarkuar të mbledhë të dhëna të rregullta për reshjet dhe prurjet ujore në basenet e lumenjve në Shqipëri, është pjesë e Komitetit Teknik Këshillues për minimizimin e rreziqeve të vështira, i krijuar në kuadër të Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile dhe i jep të dhëna qeverisë në situata të përmbytjeve. Bashkëpunimi dhe koordinimi efektiv midis IGJEUM dhe KESH – ndërmarrjes energjetike që vendos në funksion HEC-et – mund të ofrojë përfitime të rëndësishme në menaxhimin e përmbytjeve nëpërmjet rregullimeve në funksionimin e digave.





Kjo ndërlidhje është kryesisht e dukshme në Basenin e Drinit ku ndodhen tre HEC-e të mëdhenj. Funksionimi i tyre rregullohet nga “Rregullorja për shkarkimin e parcelave ujore në HEC-et e lumit Drin”. Kjo rregullore është mjaft e vjetër dhe nuk parashikon apo kërkon që KESH të marrë të dhëna për parashikimin afatshkurtër të motit. Rregullorja e përditësuar, që do të lejonte një koordinim më të mirë institucional dhe informim të të dhënave për funksionimin e HEC-eve, mund të sigurojë përfitime të rëndësishme për menaxhimin e përmbytjeve. Sistemi i Parashikimit të Përmbytjeve për të gjithë Basenin e Lumit Drin i përgatitur nga GIZ mund të jetë i dobishëm në këtë drejtim.

Sipas Vlerësimit të Nexus-it për Basenin e Drinit (gjithashtu në kuader të Projektit të Nexus për SEE) u përdor një model i integruar i ujit-energjisë për të analizuar skenarët në lidhje me funksionimin e HEC-eve të Drinit edhe në lidhje me menaxhimin e përmbytjeve. Një pasqyrë kryesore nga analiza është se ndryshimi i rregullave për funksionimin e HEC-eve për të përballuar përmbytjet (rritja e vëllimit të rezervuarëve me 20% në sezonin e lagështires) ka një ndikim të vogël në sigurinë e furnizimit me energji elektrike, por një ndikim potencialisht të rëndësishëm në kontrollin e përmbytjeve dhe reduktimin e dëmeve që lidhen me rrjedhën e poshtme, veçanërisht në rastet e përmbytjeve deri në mesatare.





RRITJA E EFIÇENCËS SË UJIT DHE ENERGJISË NË VADITJE DHE KULLIM

- Përcaktuesit e infrastrukturës së vaditjes në Shqipëri janë rezervuarët e ujit dhe kanalet e hapur të cilët janë ndërtuar dekada më parë dhe kanë nevojë për riparim, për arsye sigurie dhe për të rritur kapacitetin. Në të njëjtën kohë, pompat e kullimit janë të vjetra dhe kërkojnë kursim të lartë energjie.
- Autoritetet vendore janë organet përgjegjëse për funksionimin e infrastrukturës së vaditjes dhe kullimit. Megjithatë, ato shpesh kanë burime financiare të limituara, aftësi apo pajisje teknike të limituara dhe kjo pengon investimet e nevojshme në këtë sektor.

Opsionet për të trajtuar këtë çështje përfshijnë:

- Rolin e ri për Organizmat vendore të Përdoruesve të Ujit (WUOs), në vendim-marrje dhe mundësisht menaxhimin e kanaleve dytësore
- Përmirësim i kordinimit midis institucioneve qendrore dhe rajonale, përfshirë WUOs
- Plane veprimi dhe studime të fizibilitetit për përmirësimin e vaditjes (duke u fokusuar tek vaditja me pika) që do të zvogëlojë konsumin e ujit, vendos në dispozicion më shumë burime dhe zvogëlon nevojën për infrastrukturë shtesë.
- Kapja e sinergjive enegjike, për shembull, zëvendësim i pompave jo-eficçente, instalimi i paneleve diellore lundruese në rezervuarët e vaditjes, agro-fotovoltaiket, ose edhe – nëse e aplikueshme – mundësinë që instalimet e vogla të hidroçentraleve të funksionojnë jashtë sezonit vaditës





ZGJIDHJE TË BAZUARA NË NATYRË PËR TË TRAJTUAR EROZIONIN QË NDILKON NË BUJQËSI DHE DIGA

Në Shqipëri, shpyllëzimi dhe ndërhyrjet pa kriter të njeriut kanë përkeqësuar problemin e erozionit, duke rezultuar në sedimentim në diga (vadtje dhe HEC) dhe reduktim të kapacitetit të tyre në dispozicion, duke reduktuar tokat bujqësore.

Zgjidhjet me kosto të ulët dhe ato shumë-funksionale të bazuara në natyrë (NBS) mund të përdoren si masa inovative me një ndikim pozitiv në cilësinë e tokës, proceset e erozionit, gjenerimin dhe transportin e sedimenteve, ujërave të përmytjeve dhe stuhive, duke ofruar përfitime paralele në biodiversitet, shëndetin e njeriut, zhvillimin rural dhe punësimin.

Këto zgjidhje përfshijnë ripyllëzimin natyror dhe artificial, instalimin e pellgjeve të projektuara në shtratin e lumit për të ngadalësuar shpejtësinë e ujit dhe për të lehtësuar depozitimin e materialeve që kanë mbetur, pengesa/bariera të përmytura të gurit në shtratin e përroit, etj.


Në lidhje me këtë, nevojiten praktika shtesë për menaxhimin e pyjeve, si edhe kordinim i përmirësuar midis autoriteteve qendrore dhe vendore dhe institucioneve teknike dhe administrative





PËRFUNDIM

Për Shqipërinë, përmirësim i kordinimit të sektorëve të ndryshëm, integrimi i objektivave të politikave të tyre dhe integrimi i praktikave të përbashkëta të menaxhimit dhe planifikimit të infrastrukturës përmes një perspektive të Nexus, mund të reduktojë ndjeshëm kostot, të rrisë efijencat dhe ndihmojnë në garantimin e sigurisë së furnizimit dhe kontribuojnë në rritjen ekonomike të vendit, prosperitetin njerëzor dhe ekosistemet të shëndetshme.





© Thomais Vlachogianni/MIO-ECSDE

“Faza e II-të e Vlerësimit të Nexus për “Basenin e Lumit në Shqipëri” është përgatitur sipas projektit për “Nxitjen e Menaxhimit të Qëndrueshëm të Burimeve Natyrore në Europën Jug-lindore, përmes përdorimit të qasjes Nexus” financuar nga Agjensia Austriake për Zhvillim (ADA), njësia operative e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim, dhe zbatuar nga Partneriteti Global i Ujit për Mesdheun (GWP-Med) në partneritet me Komisionin Ekonomik për Europën e Kombeve të Bashkuara (UNECE). Versioni original në gjuhën Angleze i këtij përkthimi ndodhet në faqen e internetit www.gwp.org/seenexus

